

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 21

Efektet e Ndryshimit në Kurset e Këmbimit

Objektivi

- 1 Një njësi ekonomike mund të kryejë aktivitete me jashtë në dy mënyra. Ajo mund të ketë transaksione në monedha të huaja ose mund të ketë operacione të kryera jashtë vendit. Për më tepër, një njësi ekonomike mund të paraqesë pasqyrat e saj financiare në një monedhë të huaj. Objektivi i këtij standardi është që të përshkruajë mënyrën se si duhet të përfshihen transaksionet në monedhë të huaj dhe operacionet jashtë vendit në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike dhe se si duhet të përkthehen këto pasqyra në monedhën e paraqitjes.
- 2 Çështjet kryesore kanë të bëjnë me përcaktimin e kursit (kurseve) të këmbimit që duhet të përdoret dhe me mënyrën e raportimit të efekteve të ndryshimit të kursit të këmbimit në pasqyrat financiare.

Objekti

- 3 Ky standard do të zbatohet në:¹
 - (a) për trajtimin kontabël të transaksioneve dhe tepricave në monedhë të huaj, duke përjashtuar ato transaksione dhe teprica të derivateve që trajtohen nga SNRF 9, *Instrumentet financiare*;
 - (b) për përkthimin e rezultateve dhe pozicionit financiar të njësive ekonomike të huaja që përfshihen në pasqyrat financiare të njësive ekonomike nëpërmjet konsolidimit të plotë, konsolidimit përpjesëtimor ose metodës së kapitalit; dhe
 - (c) për përkthimin e rezultateve dhe pozicionit financiar në monedhën e paraqitjes.
- 4 SNRF 9 zbatohet për shumë derivativë në monedhë të huaj ndaj për këtë arsye këta janë përjashtuar nga ky standard. Megjithatë, ata derivativë në monedhë të huaj që nuk trajtohen nga SNRF 9 (p.sh. derivativët në monedhë të huaj që janë të përfshirë në kontratat e tjera), trajtohen sipas këtij standardi. Përveç kësaj, ky standard zbatohet kur një njësi ekonomike përkthen shumat, që u përkasin derivativave, nga monedha e tyre funksionale në monedhën e paraqitjes.
- 5 Ky standard nuk merret me trajtimin kontabël që përdoret për të mbrojtur elementët në monedhë të huaj, përfshirë këtu mbrojtjen e një investimi neto në një njësi ekonomike të huaj. SNRF 9 zbatohet për kontabilitetin mbrojtës.
- 6 Ky standard zbatohet në paraqitjen e pasqyrave financiare të një njësie ekonomike në monedhë të huaj dhe parashtrohet kërkesat për paraqitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të). Ky standard kërkon që të jepet informacion shpjegues në rastin kur përkthimi i informacionit financiar në monedhë të huaj nuk bëhet sipas këtyre kërkesave.
- 7 Ky standard nuk merret me paraqitjen në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare të atyre flukseve që vijnë si rezultat i transaksioneve në monedhë të huaj ose me përkthimin e flukseve të mjeteve monetare të një njësie ekonomike të huaj (shih SNK 7 *Pasqyrat e flukseve monetare*).

Përkufizimet

- 8 Termat e mëposhtëm janë përdorur në këtë Standard sipas këtyre kuptimeve specifike:
Kursi i mbylljes është kursi i këmbimi i çastit (spot) në fund të periudhës raportuese.
Një monedhë është e *këmbyeshme* në një monedhë tjetër nëse njësia ekonomike është në gjendje të marrë monedhën tjetër brenda një hapësire kohore që i lejon një vonesë administrative normale dhe përmes një mekanizimi (regjimi) tregu apo këmbimi në të cilin një transaksion këmbimi do të krijonte të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme me forcë.
Diferenca nga këmbimi është diferenca që rrjedh nga përkthimi i një numri të dhënë monedhe në një monedhë tjetër me kurse të ndryshme këmbimi.

¹ Shiko gjithashtu KIS7 *Futja në përdorim e Euros*.

Kursi i këmbimit është kursi me të cilin këmbehen dy monedha të ndryshme.

Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohet për të shitur një aktiv ose paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. (Shih SNRF 13 Matja me vlerën e drejtë.)

Monedha e huaj është çdo monedhë tjetër, përveç monedhës funksionale të njësisë ekonomike.

Njësi ekonomike e huaj është një njësi në formën e një njësie të kontrolluar, pjesëmarrjeje, sipërmarrjeje të përbashkët ose dege të njësisë raportuese, veprimtaritë e së cilës janë të bazuara ose kryhen në një vend të huaj ose në një monedhë të ndryshme nga ajo e njësisë raportuese.

Monedha funksionale është monedha e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin vepron njësi ekonomike.

Grupi përbëhet nga një shoqëri mëmë, si dhe të gjitha njësitë e kontrolluara prej saj.

Zëra monetarë janë njësitë e monedhës të mbajtura nga njësi ekonomike, si dhe aktivet dhe detyrimet për t'u arkëtuar ose për t'u paguar me një numër fiks ose të përcaktuar njësisht monedhe.

Investimi neto në njësi ekonomike të huaj është shuma e interesit të njësisë raportuese në aktivet neto të kësaj njësie ekonomike të huaj.

Monedha e paraqitjes është monedha me të cilën paraqiten pasqyrat financiare.

Kursi i këmbimit i çastit është kursi i këmbimit për një lëvrim të menjëhershëm.

Shtjellim i hollësishëm i përkufizimeve

Të qenit e këmbyeshme (këmbyeshmëria) (paragrafët A2–A10)

- 8A Njësia ekonomike vlerëson nëse një monedhë është e këmbyeshme në një monedhë tjetër:
- (a) në datën e matjes; dhe
 - (b) për qëllime specifike.
- 8B Nëse në datën e matjes për qëllimin specifik, njësia ekonomike nuk është në gjendje të marrë në këmbim përveçse një shumë të parëndësishme nga monedha tjetër, monedha nuk është e këmbyeshme në monedhën tjetër.

Monedha funksionale

- 9 Mjedisi ekonomik kryesor në të cilin vepron një njësi ekonomike, normalisht do të quhet ai mjedis në të cilin njësia ekonomike, kryesisht, gjeneron dhe shpenzon mjete monetare. Për të përcaktuar monedhën e saj funksionale, njësia ekonomike merr parasysh faktorët e mëposhtëm:
- (a) monedhën:
 - (i) që kryesisht ndikon në çmimet e shitjeve të mallrave dhe shërbimeve (në përgjithësi kjo do të ishte monedha në të cilën shprehen dhe shlyhen çmimet e mallrave dhe shërbimeve); dhe
 - (ii) e atij vendi që me fuqinë e tij konkurruese dhe rregullat përkatëse përcakton çmimin e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tij.
 - (b) monedha që kryesisht ndikon punën, materialet dhe kosto të tjera të sigurimit të mallrave, produkteve dhe shërbimeve (kjo shpesh do të jetë monedha në të cilën përcaktohen dhe shlyhen kosto të tilla).
- 10 Faktorët vijues mundet gjithashtu të sigurojnë evidencë për monedhën funksionale të një njësie ekonomike:
- (a) monedhën në të cilën sigurohen fondet nga aktivitetet financiare (d.m.th. emetimi instrumenteve të borxhit dhe të kapitalit neto).
 - (b) monedhën në të cilën sigurohen zakonisht të hyrat nga aktivitetet e shfrytëzimit.
- 11 Në përcaktimin e monedhës funksionale të një njësie ekonomike të huaj dhe nëse kjo monedhë është e njëjtë me atë të njësisë raportuese, (njësi raportuese në këtë kontekst do të quhet njësia që e ka njësinë ekonomike të huaj një shoqëri të kontrolluar, degë, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët) do të merren parasysh edhe këta faktorë shtesë të mëposhtëm:
- (a) nëse aktivitetet e njësisë ekonomike të huaj janë një shtrirje e mëtejshme e njësisë raportuese, apo ato kryhen me një shkallë të madhe autonomie. Si shembull për rastin e parë do të ishte njësia

ekonomike e huaj e cila vetëm shet mallrat e importuara nga njësia raportuese dhe ia kalon të ardhurat njësisë raportuese. Një shembull i të dytës është kur njësia ekonomike e huaj akumulon mjete monetare dhe zëra të tjerë monetarë, kryen shpenzime, gjeneron të ardhura dhe planifikon huamarrje, të gjitha në mënyrë thelbësore në monedhën e saj lokale.

- (b) nëse transaksionet me njësinë ekonomike raportuese zënë një pjesë të lartë ose të ulët të aktiviteve të njësisë ekonomike të huaj.
 - (c) nëse flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet e njësisë ekonomike të huaj ndikojnë drejtpërdrejt në flukset e mjeteve monetare të njësisë raportuese dhe i sjellin të ardhura asaj.
 - (d) nëse flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet e njësisë ekonomike të huaj janë të mjaftueshme për të përballuar zakonisht huamarrjet ekzistuese dhe ato të pritshme pa qenë nevoja e financimit nga njësia raportuese.
- 12 Kur treguesit e mësipërm janë të ndërthurur dhe monedha funksionale nuk është e shprehur qartë, atëherë drejtimi gjykon në përcaktimin si monedhë funksionale të asaj monedhe që përfaqëson besnikërisht efektet ekonomike të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve bazë. Si pjesë e këtij qëndrimi, drejtimi i jep prioritet treguesve parësorë të përmendur në paragrafin 9, dhe më pas shqyrton treguesit e përmendur në paragrafët 10 dhe 11, të cilët shërbejnë për të patur një evidencë mbështetëse shtesë në përcaktimin e monedhës funksionale të njësisë ekonomike.
- 13 Monedha funksionale e një njësie ekonomike pasqyron transaksionet, ngjarjet dhe kushtet bazë që lidhen me të. Prandaj, monedha funksionale mbasi përcaktohet, mbetet e pandryshuar dhe ndryshon vetëm nëse ndryshojnë këto transaksione, ngjarje dhe kushte bazë.
- 14 Në qoftë se monedha funksionale është monedha e një ekonomie hiperinflacioniste, atëherë pasqyrat financiare të njësisë ekonomike riparaqiten në përputhje me SNK 29 *Raportimi financiar në ekonomitë hiperinflacioniste*. Një njësi ekonomike nuk mund t'i shmanget riparaqitjes të pasqyrave të saj financiare në përputhje me SNK 29, për shembull, duke përdorur si monedhë funksionale një monedhë tjetër të ndryshme nga ajo që përcaktohet sipas këtij standardi (e tillë si monedha funksionale e shoqërisë mëmë).

Investimi neto në një njësi ekonomike të huaj

- 15 Një njësi ekonomike mund të ketë një zë monetar që është i arkëtueshëm nga ose i pagueshëm ndaj një njësie ekonomike të huaj. Një zë, për të cilin shlyerja as nuk është e planifikuar dhe as ka mundësi që të ndodhë në një të ardhme të afërt, është në thelb pjesë e investimit neto të njësisë ekonomike në atë njësi ekonomike të huaj dhe si i tillë ai trajtohet në përputhje me paragrafët 32 dhe 33. Zëra të tillë monetarë mund të përfshijnë të arkëtueshme ose hua afatgjata. Këta zëra nuk përfshijnë kërkesat mbi debitorët apo detyrimet ndaj kreditorëve.
- 15A Njësia ekonomike që ka një zë monetar të arkëtueshëm ose të pagueshëm ndaj një njësie ekonomike të huaj përshkruar në paragrafin 15 mund të jetë çdo filial i grupit. Për shembull, një njësi ekonomike ka dy filiale, A dhe B. Filiali B është një njësi ekonomike e huaj. Filiali A i jep hua Filialit B. Për Filialin A, huaja e arkëtueshme nga Filiali B do të konsiderohet si pjesë e investimit neto të njësisë ekonomike në Filialin B, në qoftë se shlyerja e kësaj huaje nuk është as e planifikuar, as pritet që të ndodhë një gjë e tillë në të ardhmen e afërt. E njëjta gjë do të thuhet edhe nëse Filiali A do të ishte një njësi ekonomike e huaj.

Zërat monetarë

- 16 Karakteristika themelore e zërit monetar është e drejta për të arkëtuar (ose detyrimi për të paguar) një numër fiks ose të përcaktuar njësish të monedhës. Shembuj të zërave monetarë janë: pensionet dhe përfitimet e tjera të punonjësve të pagueshme në mjete monetare; provizionet që duhet të shlyhen në mjete monetare; detyrime të qirasë; dhe dividendët në mjete monetare që njihen si një detyrim. Po kështu, do të konsiderohet si zë monetar një kontratë për të marrë (ose lëvruar) një numër të ndryshueshëm instrumentesh kapitali neto të njësisë ekonomike ose një shumë të ndryshueshme aktivesh, për të cilët vlera e drejtë që duhet marrë (ose lëvruar) është e barabartë me një numër të pandryshueshëm ose të përcaktuar njësish të monedhës. Në të kundërt, karakteristika themelore e një zëri jomonetar është mungesa e të drejtës për të marrë (ose detyrimi për të lëvruar) një numër fiks ose të përcaktuar njësish të monedhës. Si shembuj të zërave jomonetarë janë: shumat e parapaguar për mallrat dhe shërbimet; emri i mirë; aktivet jomateriale; inventarët; aktivet afatgjata materiale; aktivet me të drejtë përdorimi; dhe provizionet që duhet të shlyhen nëpërmjet lëvrimit të një aktivi jomonetar.

Përmbledhje e qëndrimit të kërkuar nga ky Standard

- 17 Në përgatitjen e pasqyrave financiare, çdo njësi ekonomike—qoftë kjo njësi ekonomike e veçuar, njësi ekonomike që ka njësi ekonomike të kontrolluara të huaja (e tillë si shoqëria mëmë) apo njësi ekonomike e huaj (si filiali ose dega) —përcakton monedhën e saj funksionale në përputhje me paragrafët 9–14. Njësia ekonomike përkthen zërat në monedhë të huaj funksionale dhe raporton efektet e një përkthimi të tillë në përputhje me paragrafët 20–37 dhe 50.
- 18 Shumë njësi raportuese përfshijnë disa njësi të veçanta (p.sh grupi përbëhet nga shoqëria mëmë dhe nga një ose disa filiale). Lloje të ndryshme njësish ekonomike, qofshin anëtarë të një grupi ose jo, mund të investojnë në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët. Ato mund të kenë dhe degë. Në këto raste është e nevojshme që rezultatet dhe pozicioni financiar i çdo njësie ekonomike individuale, të përfshirë në njësinë raportuese, të përkthehen në monedhën në të cilën njësia raportuese paraqet pasqyrat e saj financiare. Ky standard lejon që si monedhë e paraqitjes e njësish raportuese të jetë cilado monedhë (ose monedha). Rezultatet dhe pozicioni financiar i çdo njësie ekonomike individuale brenda një njësie raportuese, monedha funksionale e të cilës ndryshon nga monedha e paraqitjes, përkthehen në përputhje me paragrafët 38–50.
- 19 Ky standard lejon, gjithashtu, që një njësi ekonomike e veçuar që përgatit pasqyrat financiare ose një njësi ekonomike që përgatit pasqyrat financiare individuale në përputhje me SNK 27 *Pasqyrat financiare individuale*, të paraqesë pasqyrat financiare të saj në çfarëdo monedhe (ose monedha). Në qoftë se monedha e paraqitjes së një njësie ekonomike ndryshon nga monedha funksionale e saj, atëherë rezultatet dhe pozicioni financiar i saj përkthehen në monedhën e paraqitjes në përputhje me paragrafët 38–50.

Vlerësimi i kursit të këmbimit të çastit (spot) kur një monedhë nuk është e këmbyeshme (paragrafët A11–A17)

- 19A Njësia ekonomike do të vlerësojë kursin e këmbimit të çastit (spot) në datën e matjes kur një monedhë nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër (siç përshkruhet në paragrafët 8, 8A–8B dhe A2–A10) në atë datë. Objektivi i njësish ekonomike në vlerësimin e kursit të këmbimit të çastit (spot) është të vlerësojë kursin me të cilin do të ndodhte një transaksion këmbimi i zakonshëm në datën e matjes mes pjesëmarrësve në treg sipas kushteve ekonomike mbizotëruese.

Raportimi i transaksioneve në monedhë të huaj në monedhën funksionale

Regjistrimi fillestar

- 20 Një transaksion në monedhë të huaj është një transaksion që është shprehur ose kërkon shlyerje në një monedhë të huaj, duke përfshirë transaksione që lindin kur një njësi ekonomike:
- (a) blen ose shet mallra ose shërbime, çmimi i të cilave është i shprehur në monedhë të huaj;
 - (b) merr ose jep hua, ku shumat për t'u paguar ose për t'u arkëtuar janë të shprehura në monedhë të huaj; ose
 - (c) blen ose nxjerr aktive, ose kryen ose shlyen detyrimet, të shprehura në një monedhë të huaj.
- 21 Një transaksion në monedhë të huaj në njohjen fillestare, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e këmbimit të çastit (spot)ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e transaksionit.
- 22 Data e transaksionit është data kur transaksioni fillimisht plotëson kushtet për njohjen fillestare, në përputhje me SNRF-të. Për arsye praktike, shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, për shembull, një kurs mesatar i një jave ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të huaja. Por, nëse gjatë periudhës ka luhatje të konsiderueshme të kursit të këmbimit, përdorimi i kursit mesatar nuk është i këshillueshëm.

Raportimi në fund të periudhave të mëpasshme raportuese

- 23 Në fund çdo periudhe raportuese:

- (a) zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj përkthehen duke përdorur kursin e mbylljes;
- (b) zërat jomonetarë, që maten me kosto historike në monedhë të huaj, përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; dhe
- (c) zërat jomonetarë, që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj, përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.
- 24 Vlera kontabël e një zëri përcaktohet sipas standardeve të tjera përkatëse. Për shembull, toka, ndërtesa, makineri e pajisje mund të jenë matur me vlerën e drejtë ose koston historike në përputhje me SNK 16 *Toka, ndërtesa, makineri e pajisje*. Pavarësisht se vlera kontabël është përcaktuar bazuar në koston historike apo në vlerën e drejtë, në qoftë se shumën është e përcaktuar në monedhë të huaj atëherë ajo përkthehet në monedhën funksionale në përputhje me këtë standard.
- 25 Vlera kontabël e disa zërave përcaktohet duke krahasuar dy ose më shumë vlera të tilla. Për shembull, vlera kontabël e inventarëve është vlera më e ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme në përputhje me SNK 2 *Inventarët*. Po kështu, në përputhje me SNK 36 *Zhvlerësimi i aktiveve*, vlera kontabël e një aktivi, për të cilin ekziston shenja e zhvlerësimit, është vlera më e ulët midis vlerës së tij kontabël përpara se të merreshin në konsideratë humbjet e mundshme nga zhvlerësimi, dhe shumës së tij të rikuperueshme. Kur një aktiv i tillë është një zë jomonetar dhe është matur në monedhë të huaj, vlera kontabël përcaktohet nëpërmjet krahasimit:
- (a) të koston ose të vlerës kontabël, më e përshtatshme prej tyre, përkthyer me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar shumën (d.m.th. kursi i datës së transaksionit për një zë të matur me koston historike); dhe
- (b) vlerës neto të realizueshme dhe shumës së rikuperueshme, më e përshtatshme prej tyre, përkthyer me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera (p.sh. kursi i mbylljes në fund të periudhës raportuese).
- Si rezultat i këtij krahasimi mund të njihet një humbje nga zhvlerësimi në monedhën funksionale por nuk njihet në monedhën e huaj, ose anasjelltas.
- 26 Kur ka shumë kurse këmbimi, kursi që përdoret është kursi me të cilin do të bëhej përkthimi i transaksionit ose i tepricës, sikur ky përkthim të kishte ndodhur në datën e matjes.

Njohja e diferencave nga kurset e këmbimit

- 27 Sikurse është përmendur në paragrafin 3(a) dhe 5, SNRF 9 zbatohet në kontabilitetin mbrojtës për zërat e shprehur në monedhë të huaj. Zbatimi i kontabilitetit mbrojtës kërkon që njësia ekonomike të kontabilizojë diferencat nga kurset e këmbimit në mënyrë krejt të ndryshme nga trajtimi që u bëhet këtyre diferencave sipas këtij standardi. Për shembull, SNRF 9 kërkon që diferencat nga këmbimi i zërave monetarë, të cilët klasifikohen si instrumente mbulues në mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare, të njihen fillimisht në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në masën që kjo mbrojtje është efektive.
- 28 **Diferencat e këmbimit që rrjedhin nga shlyerja e zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen fillestare gjatë periudhës kontabël aktuale ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim ose humbje të periudhës kontabël kur ato lindin, me përjashtim të atyre të përshkruara në paragrafin 32.**
- 29 Kur zërat monetare rrjedhin nga një transaksion në monedhë të huaj dhe ka një ndryshim në kursin e këmbimit midis datës së transaksionit dhe datës së shlyerjes, atëherë krijohet një diferencë këmbimi. Kur transaksioni shlyhet në të njëjtën periudhë, në të cilën ai është kryer, e gjithë diferenca e këmbimit njihet në të njëjtën periudhë kontabël. Megjithatë, kur transaksioni shlyhet në periudhën kontabël të mëpasshme, diferenca e këmbimit e njohur në secilën periudhë deri në datën e shlyerjes, përcaktohet nga ndryshimi i kurseve të këmbimit gjatë secilës periudhë kontabël.
- 30 **Kur një fitim neto ose humbje nga një zë jo-monetar njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, çdo përbërës këmbimi i atij fitimi ose humbjeje neto do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Në të kundërt, kur një fitim neto ose humbje për një zë jomonetar njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, atëherë çdo diferencë nga këmbimi do të njihet edhe ajo në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.**
- 31 Standarde të tjera kërkojnë që disa fitime neto dhe humbje të njihen drejtpërdrejt në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Për shembull, sipas SNK 16 disa fitime neto dhe humbje që rrjedhin nga rivlerësimi i tokës, makinerive dhe pajisjeve duhet të njihen drejtpërdrejt në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Kur një aktiv i tillë matet në monedhë të huaj, sipas paragrafit 23(c) të këtij standardi, shumën e rivlerësuar duhet të

përkthehet duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera, gjë që sjell një diferencë këmbimi e cila gjithashtu duhet të njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

- 32 **Diferenca e këmbimit që rrjedh nga një zë monetar i cili në thelb është pjesë e investimit neto të njësisë raportuese në një njësi ekonomike të huaj (shih paragrafin 15), do të njihet si fitim ose humbje në pasqyrën financiare individuale të njësisë raportuese ose në pasqyrën financiare individuale të njësisë ekonomike të huaj, më e përshtatshme prej tyre. Në pasqyrat financiare, që përfshijnë njësinë ekonomike të huaj dhe njësinë raportuese (p.sh. pasqyrat financiare të konsoliduara në rastin kur njësia ekonomike e huaj është filial), të tilla diferenca nga këmbimi do të njihen fillimisht si një zë i veçantë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, ndërsa me sistemin e investimit neto ato njihen si fitim ose humbje në përputhje me paragrafin 48.**
- 33 Kur një zë monetar është pjesë e investimit neto të njësisë raportuese në një njësi ekonomike të huaj dhe është i shprehur në monedhën funksionale të njësisë raportuese atëherë në pasqyrat financiare individuale të njësisë ekonomike të huaj do të njihet një diferencë nga këmbimi në përputhje me paragrafin 28. Në qoftë se një zë i tillë është i shprehur në monedhën funksionale të njësisë ekonomike të huaj, atëherë në pasqyrat financiare individuale të njësisë raportuese do të njihet diferencë nga këmbimi në përputhje me paragrafin 28. Po kështu, nëse një zë i tillë është i shprehur në një monedhë tjetër, e ndryshme nga monedha funksionale e njësisë raportuese apo e njësisë ekonomike të huaj, atëherë në pasqyrat financiare individuale të njësisë raportuese dhe në pasqyrat financiare individuale të njësisë ekonomike të huaj njihen diferenca nga këmbimi në përputhje me paragrafin 28. Diferenca të tilla nga këmbimi riklasifikohen si një zë i veçantë i kapitalit neto në pasqyrat financiare që përfshijnë njësinë ekonomike të huaj dhe njësinë raportuese (d.m.th. pasqyrat financiare ku njësia ekonomike e huaj është përfshirë nëpërmjet konsolidimit të plotë, konsolidimit përpjesëtimor apo duke përdorur metodën e kapitalit).
- 34 Kur një njësi ekonomike e mban kontabilitetin dhe regjistrimet kontabël në një monedhë që është e ndryshme nga monedha funksionale e saj, në kohën kur ajo përgatit pasqyrat financiare, të gjitha shumat përkthehen në monedhën funksionale në përputhje me paragrafët 20–26. Kjo bën që të kemi të njëjtat shuma që do të kishim nëse zërat do të ishin regjistruar qysh në fillim në monedhën funksionale. Për shembull, zërat monetarë përkthehen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e mbylljes, ndërsa zërat jomonetare, që janë matur bazuar në koston historike, përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e njohjes së transaksionit.

Ndryshime në monedhën funksionale

- 35 **Kur ka një ndryshim në monedhën funksionale të një njësie ekonomike, njësia ekonomike duhet të zbatojë procedurat e përkthimit për monedhën e re funksionale të zbatueshme në të ardhmen që nga data e ndryshimit.**
- 36 Sikurse është përmendur në paragrafin 13 monedha funksionale e njësisë ekonomike pasqyron transaksionet, ngjarjet dhe kushtet bazë që i përkasin njësisë. Sipas kësaj, sapo përcaktohet monedha funksionale, ajo mund të ndryshohet vetëm nëse ka ndonjë ndryshim në këto transaksione, ngjarje dhe kushte të rëndësishme. Për shembull, një ndryshim në monedhë, që kryesisht ndikon në çmimin e shitjes së mallrave dhe shërbimeve, mund të çojë në ndryshimin e monedhës funksionale të njësisë ekonomike.
- 37 Efekti i ndryshimit në monedhën funksionale kontabilizohet në perspektivë. Me fjalë të tjera, një njësi ekonomike i përkthen të gjitha zërat në monedhën e re funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën e ndryshimit. Shumat që rezultojnë nga përkthimi i zërave jomonetare konsiderohen si kosto e tyre historike. Diferencat nga këmbimi që rrjedhin nga përkthimi i një njësie ekonomike të huajt ë klasifikuara më parë në kapitalin neto në përputhje me paragrafët 32 dhe 39(c), nuk njihen si fitim ose humbje derisa të eliminohet operacioni.

Përdorimi i një monedhe paraqitje të ndryshme nga monedha funksionale

Përkthimi në monedhën e paraqitjes

- 38 Një njësi ekonomike mund të paraqesë pasqyrat e saj financiare në çfarëdo monedhe (ose monedha). Në qoftë se monedha e paraqitjes së një njësie ekonomike ndryshon nga monedha funksionale e saj, atëherë rezultatet dhe pozicioni financiar i saj përkthehen në monedhën e paraqitjes. Për shembull, kur një grup përmban njësi ekonomike individuale, që kanë monedha funksionale të ndryshme, rezultatet dhe pozicioni financiar i çdo njësie ekonomike shprehen në monedhën e përbashkët në të cilën janë paraqitur pasqyrat financiare të konsoliduara.

- 39 Nëse monedha funksionale e njësisë ekonomike është e ndryshme nga monedha e paraqitjes dhe të dyja janë monedha të ekonomive jo hiperinflacioniste, rezultati dhe pozicioni financiar i njësisë ekonomike do të përkthehen në monedhën e paraqitjes duke përdorur procedurat në vijim:
- (a) aktivet dhe detyrimet për çdo pasqyrë të pozicionit financiar të paraqitur (duke përfshirë krahasimet) duhet të përkthehen me kursin e mbylljes në datën e asaj pasqyre të pozicionit financiar;
 - (b) të ardhurat dhe shpenzimet e çdo pasqyre që paraqet rezultatin dhe të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (d.m.th. duke përfshirë shumat krahasuese) do të përkthehen me kurset e këmbimit në datat e kryerjes së transaksioneve; dhe
 - (c) të gjitha diferencat që lindin nga këmbimi do të njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.
- 40 Për arsye praktike, për të përkthyer zërat e të ardhurave dhe të shpenzimeve, shpesh përdoret një kurs që përafron me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, për shembull, një kurs mesatar të periudhës aktuale. Por, nëse gjatë periudhës ka luhajtje të konsiderueshme të kursit të këmbimit, përdorimi i kursit mesatar nuk është i këshillueshëm.
- 41 Diferencat e këmbimit duke i'u referuar paragrafit 39(c), lindin nga:
- (a) përkthimi i të ardhurave dhe i shpenzimeve me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit dhe nga përkthimi i aktiveve dhe i detyrimeve me kursin e mbylljes.
 - (b) përkthimi i aktiveve neto në çelje me kursin e këmbimit të mbylljes që ndryshon nga kursi i mëparshëm i mbylljes.
- Këto diferenca këmbimi nuk njihen si fitim dhe humbje të periudhës, sepse ndryshimet në kurset e këmbimit kanë pak ose nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë në flukset e tashme ose të ardhshme të mjeteve monetare nga operacionet. Shuma kumulative e diferencave të këmbimit është paraqitur në një përbërës të veçantë të kapitalit deri në daljen e njësisë ekonomike të huaj. Kur një njësi ekonomike e huaj konsolidohet, por pa qenë e zotëruar plotësisht, diferencat nga këmbimi të akumuluar, të cilat vijnë nga përkthimi dhe që u përkasin interesave minoritare, caktohen dhe njihen si pjesë e interesave minoritare në pasqyrën e pozicionit financiar e konsoliduar.
- 41A Nëse monedha funksionale e njësisë ekonomike është monedhë e një ekonomie jo hiperinflacioniste por monedha e paraqitjes është monedhë e një ekonomie hiperinflacioniste, rezultati dhe pozicioni financiar i njësisë ekonomike do të përkthehen në monedhën e paraqitjes duke përkthyer të gjitha shumat (d.m.th. aktivet, detyrimet, zërat e kapitalit neto, të ardhurat dhe shpenzimet, përfshirë shumat krahasuese) me kursin e këmbimit të mbylljes në datën e pasqyrës më të fundit të pozicionit financiar.
- 41B Nëse ekonomia, monedha e së cilës është monedhë paraqitjeje e njësisë ekonomike, nuk është më ekonomi hiperinflacioniste dhe monedha funksionale e njësisë ekonomike vijon të jetë monedhë e një ekonomie jo hiperinflacioniste, njësia ekonomike nuk do të zbatojë më paragrafin 41A, por do të zbatojë paragrafin 39. Njësia ekonomike do të veprojë kështu në mënyrë prospektive që nga fillimi i periudhës së raportimit në të cilën ekonomia nuk është më hiperinflacioniste—d.m.th. njësia ekonomike nuk do të ripërkthejë shumat që kanë rezultuar para fillimit të periudhës së raportimit.
- 42 Nëse monedha funksionale e njësisë ekonomike është e ndryshme nga monedha e paraqitjes dhe monedha funksionale është monedhë e një ekonomie hiperinflacioniste, rezultati dhe pozicioni financiar i njësisë ekonomike do të përkthehen në monedhën e paraqitjes duke përdorur procedurat në vijim:
- (a) të gjitha shumat (d.m.th. aktivet, detyrimet, zërat e kapitalit neto, të ardhurat dhe shpenzimet, përfshirë edhe shumat krahasuese) do të përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit të datës më të fundit të pasqyrës së pozicionit financiar, përveç
 - (b) kur shumat janë përkthyer në monedhën e një ekonomie hiperinflacioniste, atëherë shumat krahasuese do të jenë ato suma që janë paraqitur si suma të vitit aktual në pasqyrat financiare përkatëse të vitit të mëparshëm (d.m.th. nuk bëhen rregullime për ndryshimet e mëpasshme në nivelin e çmimeve ose ndryshimet e mëpasshme të kurseve të këmbimit).
- 43 Kur monedha funksionale e një njësie ekonomike është monedha e një ekonomie hiperinflacioniste, njësia ekonomike do të riparaqesë pasqyrat e saj financiare në përputhje me SNK 29 përpara se të zbatojë metodën e përkthimit të përshkruar në paragrafin 42, me përjashtim të shumave krahasuese që janë përkthyer në monedhën e një ekonomie jo hiperinflacioniste (shih paragrafin 42(b)). Kur ekonomia pushon së qeni hiperinflacioniste dhe njësia ekonomike nuk vazhdon më të riparaqesë pasqyrat e saj financiare në përputhje me SNK 29, atëherë ajo do të përdorë ajo do të përdorë

shumat e shprehura në nivelin e çmimeve në datën që ndërpritet riparaqitja e pasqyrave financiare, si kosto historike për përkthimin në monedhën e paraqitjes.

Përkthimi i një njësie ekonomike të huaj

- 44 Paragrafët 45–47A, në vazhdim të paragrafëve 38–43, zbatohen kur rezultatet dhe pozicioni financiar i një njësie ekonomike të huaj përkthehen në një monedhë paraqitjeje, me qëllimin që njësia ekonomike e huaj të mund të përfshihet në pasqyrat financiare të njësisë raportuese nëpërmjet konsolidimit ose metodës së kapitalit neto.
- 45 Përfshirja e rezultateve dhe e pozicionit financiar të një njësie ekonomike të huaj në ato të njësisë raportuese ndjek procedurat normale të konsolidimit, siç janë eliminimi i tepriceve ndër-grupore dhe i transaksioneve ndër-grupore të një filiali (shih SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara*). Megjithatë, kur një aktiv monetar ndër-grupor (ose detyrim), qoftë ky afatshkurtër apo afatgjatë, nuk mund të eliminohet kundrejt detyrimit korrespondues të grupit (ose aktivit), pa u treguar edhe rezultati i luhatjeve të kurseve të këmbimit në pasqyrat financiare të konsoliduara. Kjo sepse zëri monetar përfaqëson një angazhim për të konvertuar një monedhë në një tjetër dhe e ekspozon njësinë ekonomike raportuese në një fitim ose humbje përmes luhatjeve të monedhës. Kështu, në pasqyrat financiare të konsoliduara të njësisë raportuese, një diferencë e tillë nga këmbimi vazhdon të njihet si fitim ose humbje, ndërsa nëse ajo vjen nga rrethanat e përshkruara në paragrafin 32, atëherë ajo njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe e akumuluar në një zë të veçantë të kapitalit neto deri në eliminimin e njësisë ekonomike të huaj.
- 46 Kur pasqyrat financiare të një njësie ekonomike të huaj huaj janë hartuar për një datë raportimi që është e ndryshme nga ajo e njësisë raportuese, njësia ekonomike e huaj shpesh përgatit pasqyra shtesë që mbajnë të njëjtën datë me atë të pasqyrave financiare të njësisë raportuese. Kur një gjë e tillë nuk është e mundur, SNRF 10 lejon përdorimin e një date raportimi të ndryshme, me kusht që diferenca në kohë të mos jetë më shumë se tre muaj dhe të jenë bërë rregullime për efektet e çdo transaksioni të rëndësishëm apo të ngjarjeve të tjera që kanë ndodhur midis datave të ndryshme. Në këtë rast, aktivet dhe detyrimet e një njësie ekonomike të huaj përkthehen me kursin e këmbimit në fund të periudhës raportuese të njësisë operative. Kur ka ndryshime të rëndësishme në kurset e këmbimit deri në fund të periudhës raportuese të njësisë raportuese, bëhen rregullime në përputhje me SNRF 10. Në të njëjtën mënyrë veprohet kur zbatohet metoda e kapitali neto për pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta si dhe në rastin e konsolidimit përpjesëtimor për sipërmarrjet në përputhje me SNK 28 (i ndryshuar në vitin 2011).
- 47 Çdo emër i mirë që lind nga blerja e një njësie ekonomike të huaj dhe çdo rregullim i vlerës së drejtë të vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve që lindin nga blerja e asaj njësie ekonomike të huaj, duhet të trajtohen si aktive dhe detyrime të njësisë ekonomike të huaj. Pra, ato do të shprehen në monedhën funksionale të njësisë ekonomike të huaj dhe do të përkthehen me kursin e mbylljes në përputhje me paragrafët 39, 41A dhe 42.
- 47A Nëse monedha funksionale e njësisë ekonomike dhe monedha e paraqitjes janë monedha të një ekonomie hiperinflacioniste (ose janë monedha të ekonomive të ndryshme hiperinflacioniste) dhe njësia ekonomike përkthen rezultatin dhe pozicionin financiar të një njësie ekonomike të huaj monedha funksionale e të cilës është monedhë e një ekonomie jo hiperinflacioniste, njësia ekonomike nuk do të zbatojë paragrafin 41A për shumat krahasuese të asaj njësie ekonomike të huaj. Në vend të saj, njësia ekonomike do të riparaqesë shumat krahasuese të asaj njësie ekonomike të huaj të përfshira në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike të publikuara më parë, duke zbatuar indeksin e përgjithshëm të çmimit që ajo përdor për shifrat korresponduese për periudhën e mëparshme raportuese në përputhje me paragrafin 34 të SNK 29.

Nxjerrja e plotë ose e pjesshme jashtë përdorimit e një operacioni të kryer jashtë vendit

- 48 Në nxjerrjen jashtë përdorimit të një operacioni të kryer jashtë vendit, shuma akumuluar e diferencave të këmbimit në lidhje me këtë operacion të kryer jashtë vendit, e njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe e akumuluar në një përbërës të veçantë të kapitalit neto, do të riklasifikohet nga kapitali neto tek fitim ose humbje neto (si një rregullim riklasifikimi) kur njihet fitimi ose humbja në nxjerrjen jashtë përdorimit (shih SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare*).
- 48A Përveç daljes të gjithë interesave të një njësie ekonomike në një njësi ekonomike të huaj, daljet pjesore të mëposhtme kontabilizohen si dalje:

- (a) kur dalja e pjesshme përfshin humbjen e kontrollit të një filiali që përfshin një njësi ekonomike të huaj, pavarësisht nëse njësia ekonomike ruan një interes jo-kontrollues në ish-filialit të saj pas daljes së pjesshme; dhe
- (b) kur interesi i mbajtur pas daljes së pjesshme të një interesi në një marrëveshje të përbashkët ose një dalje e pjesshme të një interesi në një pjesëmarrje që përfshin një njësi ekonomike të huaj është një aktiv financiar që përfshin një njësi ekonomike të huaj.
- 48B Në daljen e një filiali që përfshin një njësi ekonomike të huaj, shuma kumulative e diferencave të këmbimit në lidhje me këtë operacion të huaj që kanë qenë shpërndarë interesave jo-kontrolluese do të çregjistrohet, por nuk do të riklasifikohen në fitim ose humbje.
- 48C Në daljen e pjesshme të një filiali që përfshin një njësi ekonomike të huaj, njësia ekonomike duhet të ri-shpërndajë pjesën përpjestimore të shumës kumulative të diferencave të këmbimit të njohura në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në interes jo-kontrolluese në atë njësi ekonomike të huaj. Në çdo dalje të pjesshme tjetër të një njësie ekonomike të huaj njësia ekonomike do të riklasifikojë në fitim ose humbje vetëm pjesën përpjestimore të shumës kumulative të diferencave të këmbimit të njohura në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.
- 48D Një dalje e pjesshme e interesit të një njësie ekonomike në një njësi ekonomike të huaj është çdo zvogëlim në interesat pronësore të një njësie ekonomike në një njësi ekonomike të huaj, me përjashtim të atyre zvogëlimeve në paragrafin 48A që kontabilizohen si dalje.
- 49 Një njësi ekonomike mund të bëjë dalje ose të bëjë dalje pjesore të interesave të saj një njësie ekonomike të huaj nëpërmjet shitjes, likuidimit, ripagimit të kapitalit aksionar ose braktisjes së të gjitha ose një pjesë të asaj njësie ekonomike. Një çregjistrim i vlerës kontabël neto të një njësie ekonomike të huaj, qoftë për shkak të humbjeve të veta, ose për shkak të një zhvlerësimi të njohur nga investitori, nuk përbën një dalje të pjesshme. Prandaj, asnjë pjesë e fitimit ose humbjes të këmbimit të njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse nuk riklasifikohet në fitim ose humbje në kohën e një çregjistrimi të vlefshëm.

Efektet e të gjitha diferencave nga këmbimi në tatime

- 50 Fitimet neto dhe humbjet nga transaksionet në monedhë të huaj dhe diferencat nga këmbimi që rrjedhin nga përkthimi në monedhë të huaj i rezultateve dhe i pozicionit financiar të një njësie ekonomike (përfshirë edhe njësinë ekonomike të huaj) mund të shoqërohen me efekte tatimore. Këto efekte tatimore trajtohen sipas SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat*.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 51 Në paragrafët 53 dhe 55–57, referencat ndaj "monedhës funksionale" zbatohen, në rastin e një grupi, në monedhën funksionale të shoqërisë mëmë.
- 52 Njësia ekonomike jep si informacion shpjegues:
- (a) shumën e diferencave të këmbimit të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveç atyre që rrjedhin nga matja e instrumenteve financiare me vlerën e drejtë dhe që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me SNRF 9; dhe
- (b) diferencat neto të këmbimit të klasifikuar si një zë më vete në kapitalin neto, si dhe rakordin e kësaj difference në fillim dhe në mbyllje të periudhës kontabël.
- 53 Kur monedha e paraqitjes është e ndryshme nga monedha funksionale, një gjë e tillë do të tregohet së bashku me informacionin shpjegues që jepet në lidhje me monedhën funksionale edhe arsyeja e përdorimit të një monedhe të ndryshme paraqitjeje.
- 53A Nëse njësia ekonomike zbaton paragrafin 41A për të përkthyer rezultatin dhe pozicionin e saj financiar ose rezultatin dhe pozicionin financiar të një njësie ekonomike të huaj, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për faktin se të gjitha shumat (d.m.th. aktivet, detyrimet, zërat e kapitalit neto, të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe, nëse nuk zbatohet paragrafi 47A shumat krahasuese) në pasqyrat e saj financiare ose rezultatet dhe pozicioni financiar i njësisë ekonomike të huaj, janë përkthyer me kursin e këmbimit të mbylljes në datën e pasqyrës më të fundit të pozicionit financiar.
- 53B Nëse monedha funksionale e njësisë ekonomike është monedhë e një ekonomie hiperinflacioniste dhe njësia ekonomike zbaton paragrafët 41A dhe 47A për të përkthyer rezultatet dhe pozicionin financiar të njësisë ekonomike të saj të huaja, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues përmbledhës financiar mbi njësitë e saj ekonomike të huaja, që u mundëson përdoruesve të

pasqyrave financiare të vlerësojnë efektin e këtyre njësive ekonomike të huaja në rezultatin dhe pasqyrat financiare të njësisë ekonomike. Njësia ekonomike duhet të emërtojë informacionin financiar përmbledhës krahasues mbi njësitë e saj ekonomike të huaja, për të identifikuar që njësia ekonomike ka përgatitur informacionin duke zbatuar indeksin e përgjithshëm të çmimit që ajo përdor për shifrat korresponduese për periudhën e mëparshme raportuese në përputhje me paragrafin 34 të SNK 29.

- 54 Kur ndodh një ndryshim në monedhën funksionale ose të njësisë raportuese ose të një njësie ekonomike të huaj të rëndësishme, atëherë do të paraqitet ky fakt dhe të jepet informacion shpjegues në lidhje me shkaktuesin e ndryshimit në monedhën funksionale.
- 54A Nëse njësia ekonomike zbaton paragrafin 41B, ajo duhet të japë informacion shpjegues për faktin që monedha e saj e paraqitjes nuk është më monedha e një ekonomike hiperinflacioniste.
- 55 Kur një njësi ekonomike i paraqet pasqyrat e saj financiare në një monedhë të ndryshme nga monedha e saj funksionale, ajo duhet t'i përshkruajë pasqyrat e saj financiare në përputhje me SNRF-të vetëm nëse përmbushin të gjitha kërkesat e SNRF-ve duke përfshirë edhe metodën e përkthimit të paraqitur në paragrafët 39, 41A, dhe 42 dhe 47A.
- 56 Në disa raste, njësia ekonomike i paraqet pasqyrat e saj financiare ose çdo informacion tjetër financiar në një monedhë që nuk është monedha e saj funksionale duke mos përmbushur kërkesat e paragrafit 55. Për shembull, një njësi ekonomike mund të konvertojë në një monedhë tjetër vetëm disa zëra të përzgjedhur nga pasqyrat e saj financiare. Po kështu, në qoftë se monedha funksionale e një njësie ekonomike nuk është monedha e një ekonomie hiperinflacioniste, atëherë njësia ekonomike mund të konvertojë pasqyrat financiare në një monedhë tjetër duke përkthyer të gjitha zërat me kursin e mbylljes, atë më të fundit. Meqë të tilla konvertime nuk janë në përputhje me SNRF-të, duhet të jepet informacion shpjegues sipas paragrafit 57.
- 57 Kur një njësi ekonomike i paraqet pasqyrat e saj financiare ose çdo informacion tjetër financiar në një monedhë të ndryshme si nga monedha e saj funksionale ashtu edhe nga ajo e paraqitjes duke mos përmbushur kërkesat e paragrafit 55, atëherë ajo do:
- (a) tregojë në mënyrë të qartë informacionin suplementar për ta bërë të dallueshëm nga informacioni që përmbush kërkesat e SNRF-ve;
 - (b) të japë informacion shpjegues për monedhën në të cilën është paraqitur informacioni suplementar; dhe
 - (c) të japë informacion shpjegues për monedhën funksionale të njësisë ekonomike dhe për metodën e përkthimit që është përdorur në përcaktimin e informacionit suplementar.
- 57A Kur njësia ekonomike vlerëson një kurs këmbimi të çastit (spot), sepse monedha nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër (shiko paragrafin 19A), njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues, që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të saj, të kuptojnë sesi monedha e pakëmbyeshme në një monedhë tjetër ndikon ose pritet që të ndikojë performancën financiare, pozicionin financiar dhe flukset monetare të njësisë ekonomike. Për të realizuar këtë objektiv, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi:
- (a) natyrën dhe efektet financiare të monedhës jo të këmbyeshme në një monedhë tjetër;
 - (b) kursin (kurset) e këmbimit të çastit (spot) të përdorur;
 - (c) procesin e vlerësimit; dhe
 - (d) rreziqet ndaj të cilave është ekspozuar njësia ekonomike për shkak se monedha nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër.
- 57B Në paragrafët A18–A20 specifikohet sesi njësia ekonomike zbaton paragrafin 57A.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

- 58 Njësia ekonomike do të zbatojë këtë standard për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2005 e në vijim. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2005, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 58A *Investimi neto në një njësi ekonomike të huaj* (Ndryshimi në SNK 21), i publikuar në dhjetor 2005, ka shtuar paragrafin 15A dhe ka ndryshuar paragrafin 33. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2006 e në vijim. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm.
- 59 Një njësi ekonomike do të zbatojë paragrafin 47 në perspektivë për të gjitha blerjet e bëra mbas fillimit të periudhës së raportimit financiar në të cilën ky standard zbatohet për herë të parë. Për blerjet më të hershme

lejohe zbatimi retrospektiv i paragrafit 47. Blerja e një njësie ekonomike të huaj e trajtuar në perspektivë, por që ka ndodhur përpara datës së vënies në zbatim të këtij standardi për herë të parë, nuk do të riparaqitet në vitet e shkuara nga njësia ekonomike. Po kështu, është me vend që emri i mirë dhe rregullimet me vlerën e drejtë, që lindin nga blerja, të trajtohen si aktive dhe detyrime të njësisë ekonomike, sesa si aktive dhe detyrime të njësisë ekonomike të huaj. Prandaj, emri i mirë dhe rregullimet me vlerën e drejtë tashmë do të jenë ose të shprehura në monedhën funksionale të njësisë ekonomike ose do të jenë zëra jomonetarë në monedhë të huaj, të cilët do të raportohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e blerjes.

- 60 Të gjitha ndryshimet e tjera për shkak të zbatimit të këtij standardi do të trajtohen në përputhje me kërkesat e SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*.²
- 60A SNK 1 (rishikuar në 2007) ndryshoi terminologjinë e përdorur në të gjithë SNRF-të. Përveç kësaj, ajo ka ndryshuar paragrafët 27, 30-33, 37, 39, 41, 45, 48 dhe 52. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në datën 1 janar 2009 ose më pas. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 1 (rishikuar në 2007) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.³
- 60B SNK 27 (i ndryshuar në vitin 2008) shtoi paragrafët 48A-48D dhe ka ndryshuar paragrafin 49. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 korrik 2009 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 27 (ndryshuar në 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë të hershme.
- 60C [Fshirë]
- 60D Paragrafi 60B u ndryshua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Lejohe aplikimi më i hershëm.
- 60E [Fshirë]
- 60F SNRF 10 dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, të publikuar në maj 2011, ka ndryshuar paragrafët 3(b), 8, 11, 18, 19, 33, 44-46 dhe 48A. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur të zbatojë SNRF 10 dhe SNRF 11.
- 60G SNRF 13, publikuar në maj 2011, ka ndryshuar përkufizimin e vlerës së drejtë në paragrafin 8 dhe ka ndryshuar paragrafin 23. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 13.
- 60H *Paraqitja e zërave në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse* (Ndryshime në SNK 1), publikuar në qershor 2011, ndryshoi paragrafin 39. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNK 1, të ndryshuar në qershor 2011.⁴
- 60I [Fshirë]
- 60J SNRF 9, i publikuar në korrik 2014, ka ndryshuar paragrafët 3, 4, 5, 27 dhe 52 dhe janë fshirë paragrafët 60C, 60E dhe 60I. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 9.
- 60K SNRF 16 *Qiratë*, e publikuar në janar 2016, ndryshoi paragrafin 16. Njësia ekonomike e zbaton këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.
- 60L *Mungesa e Këmbyeshmërisë*, i publikuar në gusht 2023, ndryshoi paragrafët 8 dhe 26, si dhe shtoi paragrafët 8A-8B, 19A, 57A-57B dhe Shtojcën A. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudha raportuese vjetore që fillojnë me 1 janar 2025 e në vijim. Lejohe aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Data e zbatimit fillestar është fillimi i periudhës vjetore të raportimit në të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë këto ndryshime.
- 60M Kur zbaton *Mungesën e Këmbyeshmërisë*, njësia ekonomike nuk do të riparaqesë informacion krahasues. Por:
- (a) kur njësia ekonomike raporton transaksione në monedhë të huaj në monedhën e saj funksionale dhe në datën e zbatimit për herë të parë del në përfundimin se monedha e saj funksionale nuk është e këmbyeshme në monedhën e huaj ose, nëse është e zbatueshme, del në përfundimin se monedha e huaj nuk është e këmbyeshme në monedhën e saj funksionale, njësia ekonomike në datën e zbatimit për herë të parë duhet:

² Kur publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* në prill 2024, BSNK ndryshoi titullin e SNK 8 në *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*.

³ Kur publikoi SNRF18, BSNK mbarti këto kërkesa të SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* tek SNRF 18.

⁴ Kur publikoi SNRF18, BSNK mbarti këto kërkesa të SNK 1 tek SNRF 18.

- (i) të përkthejë zërat monetarë në monedhë të huaj të ndikuar dhe zërat jo monetarë të matur me vlerën e drejtë në një monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të çastit (spot) të vlerësuar në atë datë; dhe
 - (ii) të njohë efektet e zbatimit për herë të parë të ndryshimeve si një rregullim të tepricës së çeljes së fitimeve të pashpërndara.
- (b) kur njësia përdor një monedhë paraqitjeje të ndryshme nga monedha e saj funksionale, ose përkthen rezultatet dhe pozicionin financiar të një operacioni të kryer jashtë vendit dhe në datën e zbatimit për herë të parë del në përfundimin se monedha funksionale e saj (ose monedha funksionale e operacionit të kryer jashtë vendit) nuk është e këmbyeshme në monedhën e saj të paraqitjes ose, nëse është e zbatueshme, del në përfundimin se monedha e saj e paraqitjes nuk është e këmbyeshme në monedhën funksionale të saj (ose në monedhën funksionale të operacionit të kryer jashtë vendit), në datën e zbatimit për herë të parë njësia ekonomike duhet:
- (i) të përkthejë aktivet dhe detyrimet e ndikuara duke përdorur kursin e këmbimit të çastit (spot) të vlerësuar në atë datë;
 - (ii) të përkthejë zërat e ndikuar të kapitalit neto duke përdorur kursin e këmbimit të çastit (spot) të vlerësuar në atë datë sikur monedha funksionale e njësisë ekonomike të ishte e një ekonomie hiperinflacioniste; dhe
 - (iii) të njohë efektet e zbatimit për herë të parë të ndryshimeve, si një rregullim të shumës së akumuluar të diferencave nga përkthimi—të grumbulluara në një përbërës të veçantë të kapitalit.
- 60N SNRF 18, i publikuar në prill 2024, ndryshoi paragrafin 48. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.
- 60O *Përkthimi në një Monedhë Paraqitjeje Hiperinflacioniste*, i publikuar në nëntor 2025, shtoi paragrafët 41A–41B, 47A, 53A–53B, 54A dhe 60P, si dhe ndryshoi paragrafët 39, 42, 44, 47 dhe 55. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore raportuese që fillojnë në datën 1 janar 2027 ose pas kësaj date. Lejohet zbatimi i ndryshimeve për periudha më të hershme. Nëse njësia ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 60P Kur zbaton *Përkthimi në një Monedhë Paraqitjeje Hiperinflacioniste*:
- (a) njësia ekonomike, për të cilën monedhat funksionale dhe të paraqitjes janë monedha të një ekonomie hiperinflacioniste (ose janë monedha të ekonomive të ndryshme hiperinflacioniste) dhe që përkthen rezultatet dhe pozicionin financiar të njësive ekonomike të huaja, që kanë si monedhë funksionale atë të një ekonomie jo hiperinflacioniste, duhet:
 - (i) të zbatojë ndryshimet nga fillimi i periudhës vjetore të raportimit në të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë këto ndryshime;
 - (ii) të riparaqesë shumat krahasuese të njësisë të saj ekonomike të huaj të përfshira në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike të publikuara më parë duke zbatuar indeksin e përgjithshëm të çmimit që ajo përdor për shifrat korresponduese në përputhje me paragrafin 34 të SNK 29; dhe
 - (iii) të japë informacion shpjegues financiar të përmbledhur krahasues mbi njësitë e saj ekonomike të huaja dhe të emërtojë këtë informacion për të identifikuar se njësia ekonomike ka përgatitur informacionin duke zbatuar pikën (ii).
 - (b) me përjashtim të sa specifikuar në germën (a), njësia ekonomike duhet të zbatojë ndryshimet në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8; dhe
 - (c) njësisë ekonomike nuk i kërkohet të japë informacionin shpjegues që ndryshe do të kërkohej nga paragrafi 28(f) i SNK 8. Në mënyrë të ngjashme, një njësie ekonomike që zbaton SNRF 19 *Filialet pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese* nuk i kërkohet të japë informacionin shpjegues që ndryshe do të kërkohej nga paragrafi 178(f) të SNRF 19.

Shfuqizimi deklarave të tjera

- 61 Ky standard zëvendëson SNK 21 *Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit* (rishikuar në vitin 1993).
- 62 Ky Standard zëvendëson Interpretimet e mëposhtme:
- (a) KIS-11 *Diferenca nga këmbimi—Kapitalizimi i humbjeve që rrjedhin nga zhvlerësimi i fortë i monedhës*;

- (b) KIS-19 *Monedha raportuese—Matja dhe paraqitja e pasqyrave financiare sipas SNK 21 dhe SNK 29; dhe*
- (c) KIS-30 *Monedha raportuese—Përkthimi nga monedha e matjes në mondhën e paraqitjes.*


Shtojca A

Udhëzime të zbatimit

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit.

Këmbyeshmëria

- A1 Qëllimi i diagramës në vijim është që të ndihmojë njësitë ekonomike të vlerësojnë nëse një monedhë është e këmbyeshme dhe të vlerësojnë kursin e këmbimit të çastit (spot) kur një monedhë nuk është e këmbyeshme.



Hapi I: Vlerësimi nëse një monedhë është e këmbyeshme (paragrafët 8 dhe 8A–8B)

- A2 Paragrafët A3–A10 paraqesin udhëzime të zbatimit për të ndihmuar njësinë ekonomike në vlerësimin nëse monedha është e këmbyeshme në një monedhë tjetër. Njësia ekonomike përcakton që monedha nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër edhe pse monedha tjetër mund të jetë e këmbyeshme në monedhën e njësisë ekonomike (drejtimi tjetër). Për shembull, njësia ekonomike mund të përcaktojë që monedha PC nuk është e këmbyeshme në monedhën LC edhe pse monedha LC është e këmbyeshme në monedhën PC.

Harku kohor

- A3 Paragrafi 8 e përkufizon kursin e këmbimi të çastit (spot) si kursi i këmbimit për lëvrimin e menjëhershëm. Megjithatë, një transaksion këmbimi jo gjithmonë mund të përfundojë menjëherë për shkak të kërkesave ligjore apo rregullatore, ose për arsye praktike, si ditët e festave zyrtare. Një vonesë administrative normale në marrjen e monedhës tjetër nuk e përjashton monedhën nga këmbyeshmëria me monedhën tjetër. Se çfarë përbën një vonesë normale administrative varet nga faktet dhe rrethanat.

Aftësia (kapaciteti) për të marrë monedhën tjetër

- A4 Kur vlerëson nëse një monedhë është e këmbyeshme në një monedhë tjetër, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë më tepër aftësinë (kapacitetin) për të marrë monedhën tjetër sesa synimin apo vendimin e saj për ta bërë këtë. Në varësi të kërkesave të tjera të paragrafëve A2–A10, një monedhë është e këmbyeshme në një monedhë tjetër nëse njësia ekonomike është në gjendje të marrë (përfitojë) monedhën tjetër—drejtpërdrejt ose

jo—edhe nëse synon ose vendos të mos e bëjë këtë. Për shembull, në varësi të kërkesave të tjera të paragrafëve A2–A10, pavarësisht nëse njësi ekonomike synon ose vendos të marrë PC, monedha LC është e këmbyeshme në monedhën PC nëse njësi ekonomike është në gjendje ose të këmbejë LC për PC, ose të këmbejë LC në një monedhë tjetër (FC) dhe më pas të këmbejë FC në PC.

Mekanizmat (Regjimet) e tregjeve ose të këmbimit

- A5 Kur vlerësohet nëse një monedhë është e këmbyeshme me një monedhë tjetër, njësi ekonomike do të marrë në konsideratë vetëm mekanizmat (regjimet) e tregjeve ose të këmbimit në të cilat një transaksion këmbimi të monedhës në një monedhë tjetër do të krijojë të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme me forcë. Ekzekutimi me forcë (i pashmangshëm) është çështje ligjore. Nëse një transaksion këmbimi, në një mekanizëm (regjim) tregu ose këmbimi, do të krijojë të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme me forcë varet nga faktet dhe rrethanat.

Qëllimi për të marrë monedhën tjetër

- A6 Kurse këmbimi të ndryshme mund të jenë të mundshme për përdorues të ndryshëm të një monedhe. Për shembull, një juridiksion, që ndeshet me presionin e bilancit të tij të pagesave, mund të dëshirojë të kufizojë pagesat e kapitalit (të tilla si pagesat e dividendëve) në juridiksione të tjera, por të nxisë importin e të mirave specifike nga këto juridiksione. Në rrethanat të tilla, autoritetet përkatëse mund:
- (a) të vendosin një kurs këmbimi të preferuar për importin e këtyre të mirave dhe një kurs këmbimi ‘penalizues’ për pagesat e kapitalit në juridiksione të tjera, duke sjellë zbatimin e kurseve të ndryshme të këmbimit për transaksione të ndryshme këmbimi; ose
 - (b) të bëjnë monedhën tjetër të disponueshme vetëm për pagesën e importeve të këtyre të mirave dhe jo për pagesat e kapitalit në juridiksione të tjera.
- A7 Për pasojë, nëse një monedhë është e këmbyeshme në një monedhë tjetër mund të varet nga qëllimi për të cilin njësi ekonomike merr (apo hipotetikisht mund të ketë nevojë të marrë) monedhën tjetër. Për vlerësimin e këmbyeshmërisë:
- (a) kur njësi ekonomike raporton transaksionet në monedhë të huaj në monedhën e saj funksionale (shiko paragrafët 20–37), njësi ekonomike do të supozojë se qëllimi në marrjen e monedhës tjetër është realizimi ose shlyerja individuale e transaksioneve në monedhë të huaj, aktiveve ose detyrimeve.
 - (b) kur njësi ekonomike përdor një monedhë paraqitjeje të ndryshme nga monedha e saj funksionale (shiko paragrafët 38–43), njësi ekonomike do të supozojë se qëllimi në marrjen e monedhës tjetër është realizimi ose shlyerja e aktiveve neto ose detyrimeve neto të saj.
 - (c) kur njësi ekonomike përkthen rezultatet dhe pozicionin financiar të një operacioni të kryer jashtë vendit në monedhën e paraqitjes (shiko paragrafët 44–47), njësi ekonomike do të supozojë se qëllimi në marrjen e monedhës tjetër është realizimi ose shlyerja e investimit neto të saj në operacionin e kryer jashtë vendit.
- A8 Realizimi i aktiveve neto ose investimit neto në një operacion të kryer jashtë vendit të njësisë ekonomike mund të arrihet për shembull:
- (a) me shpërndarjen e një kthimi financiar tek pronarët e njësisë ekonomike;
 - (b) me marrjen e një kthimi financiar nga operacioni i kryer jashtë vendit i njësisë ekonomike; ose
 - (c) me rikuperimin e investimit nga njësi ekonomike ose pronarët e saj, si p.sh. përmes nxjerrjes jashtë përdorimit të investimit.
- A9 Njësi ekonomike do të vlerësojë nëse monedha është e këmbyeshme në një monedhë tjetër veçmas për secilin qëllim të specifikuar në paragrafin A7. Për shembull, njësi ekonomike do të vlerësojë këmbyeshmërinë për qëllimin e raportimit të transaksionit në monedhë të huaj në monedhën e saj funksionale (shiko paragrafin A7(a)) veçmas nga këmbyeshmëria për qëllimin e përkthimit të rezultateve dhe pozicionit financiar në një operacion të kryer jashtë vendit (shiko paragrafin A7(c)).

Aftësia (kapaciteti) për të marrë vetëm shuma të kufizuara të monedhës tjetër

- A10 Një monedhë nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër nëse, për një qëllim të specifikuar në paragrafin A7, njësi ekonomike nuk është në gjendje të marrë më tepër se një shumë të parëndësishme nga monedha

tjetër. Njësia ekonomike do të vlerësojë rëndësinë e shumës në monedhën tjetër, që është në gjendje të marrë për qëllimin specifik, duke krahasuar atë shumë me shumën gjithsej të monedhës tjetër të kërkuar për atë qëllim. Për shembull, njësia ekonomike me monedhën funksionale LC ka detyrime të përcaktuara në monedhën FC. Njësia ekonomike vlerëson nëse shuma gjithsej e FC, që mund të marrë me qëllim shlyerjen e atyre detyrimeve, nuk është veçse një shumë e parëndësishme krahasuar me shumën totale (gjithsej) të tepricave të detyrimeve të saj të përcaktuara në monedhën FC.

Hapi II: Vlerësimi i kursit të këmbimit të çastit (spot) kur një monedhë nuk është e këmbyeshme (paragrafi 19A)

- A11 Ky Standard nuk specifikon sesi një njësi ekonomike vlerëson kursin e këmbimit të çastit (spot) për të plotësuar objektivin në paragrafin 19A. Një njësi ekonomike mund të përdorë një kurs këmbimi të vrojtueshëm pa rregullime (shiko paragrafët A12–A16) ose një teknikë tjetër vlerësimi (shiko paragrafin A17).

Përdorimi i një kursi këmbimi të vrojtueshëm pa rregullim

- A12 Kur vlerëson kursin e këmbimit të çastit (spot) siç kërkohet nga paragrafi 19A, njësi ekonomike mund të përdorë një kurs këmbimi të vrojtueshëm pa rregullim nëse ai kurs plotëson objektivin në paragrafin 19A. Shembuj të një kursi këmbimi të vrojtueshëm përfshijnë:
- (a) një kurs këmbimi i çastit (spot) për një qëllim të ndryshëm nga ai për të cilin njësi ekonomike vlerëson këmbyeshmërinë (shiko paragrafët A13–A14); dhe
 - (b) kursin e parë të këmbimit me të cilin njësi ekonomike është në gjendje të marrë monedhën tjetër për qëllimin e specifikuar pasi është përcaktuar këmbyeshmëria e monedhës (kursi i parë pasardhës i këmbimit) (shiko paragrafët A15–A16).

Përdorimi i një kursi këmbimi të vrojtueshëm për një qëllim tjetër

- A13 Një monedhë që nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër për një qëllim mund të jetë e këmbyeshme në atë monedhë për një qëllim tjetër. Për shembull, njësi ekonomike mund të jetë në gjendje të marrë një monedhë për importin e të mirave specifike (të caktuara), por jo për të paguar dividendët. Në situata të tilla, njësi ekonomike mund të dalë në përfundimin se një kurs këmbimi i vrojtueshëm për një qëllim tjetër plotëson objektivin në paragrafin 19A. Nëse kursi plotëson objektivin në paragrafin 19A, njësi ekonomike mund të përdorë atë kurs si kursin e vlerësuar të këmbimit të çastit (spot).
- A14 Në vlerësimin nëse një kurs i tillë i vrojtueshëm i këmbimit plotëson objektivin në paragrafin 19A, njësi ekonomike do të marrë në konsideratë mes faktorëve të tjerë:
- (a) *nëse ekzistojnë disa kurse këmbimi të vrojtueshme*—ekzistenca e më shumë se një kursi këmbimi të vrojtueshëm mund të tregojë që kurset e këmbimit janë vendosur për të nxitur ose penguar njësitë ekonomike në marrjen e shumës në monedhën tjetër për qëllime të caktuara. Këto kurse këmbimi të vrojtueshme mund të përfshijnë një ‘stimul’ ose ‘penalitet’ dhe prandaj mund të mos reflektojnë kushtet ekonomike mbizotëruese.
 - (b) *qëllimin për të cilin monedha është e këmbyeshme*—nëse njësi ekonomike është në gjendje të marrë monedhën tjetër vetëm për qëllime të caktuara (si p.sh. për të importuar furnizime urgjente), kursi i këmbimit të vrojtueshëm mund të mos reflektojë kushtet ekonomike mbizotëruese.
 - (c) *natyrën e kursit të këmbimit*—ka më shumë mundësi që një kurs këmbimi i vrojtueshëm në tregun e lirë (i ndryshueshëm) të pasqyrojë kushtet ekonomike mbizotëruese sesa një kurs këmbimi të përcaktuar përmes ndërhyrjeve të rregullta nga autoritetet përkatëse.
 - (d) *frekuencën me të cilën përditësohen kurset e këmbimit*—ka më pak mundësi që një kurs këmbimi i vrojtueshëm, i pandryshuar në kohë, të pasqyrojë kushtet ekonomike mbizotëruese krahasuar me një kurs këmbimi të vrojtueshëm që përditësohet ditë pas dite (ose edhe më shpesh).

Përdorimi i kursit të parë pasardhës të këmbimit

- A15 Një monedhë që nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër në datën e matjes për një qëllim specifik mund të bëhet më pas e këmbyeshme në atë monedhë për atë qëllim. Në situata të tilla, njësi ekonomike mund të dalë në përfundimin se kursi i parë pasardhës i këmbimit plotëson objektivin në paragrafin 19A. Nëse kursi plotëson objektivin në paragrafin 19A, njësi ekonomike mund të përdorë atë kurs si kursin e vlerësuar të këmbimit të çastit (spot).
- A16 Kur vlerëson nëse kursi i parë pasardhës i këmbimit plotëson objektivin në paragrafin 19A, njësi ekonomike do të marrë në konsideratë mes faktorëve të tjerë:

- (a) *kohën mes datës së matjes dhe datës në të cilën përcaktohet këmbyeshmëria*—sa më e shkurtër të jetë kjo periudhë, aq më shumë ka mundësi që kursi i parë pasardhës i këmbimit të pasqyrojë kushtet ekonomike mbizotëruese.
- (b) *normat e inflacionit*—kur një ekonomi është objekt i inflacionit të lartë, përfshirë rastin kur një ekonomi është hiperinflacioniste (siç specifikohet në SNK 29 *Raportimi financiar në ekonominë hiperinflacioniste*), çmimet ndryshojnë shpesh papritur, ndoshta disa herë gjatë një dite. Për pasojë, kursi i parë pasardhës i këmbimit për një monedhë të një ekonomie të tillë mund të mos pasqyrojë kushtet ekonomike mbizotëruese.

Përdorimi i një teknike tjetër vlerësimi

- A17 Njësia ekonomike, që përdor një tjetër teknikë vlerësimi, mund të përdorë çdo kurs këmbimi të vrojtueshëm—përfshirë kurset nga transaksionet e këmbimit në mekanizmat (regjimet) e tregjeve ose të këmbimit që nuk krijojnë të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme me forcë—dhe ta rregullojë atë kurs, sipas nevojës, për të plotësuar objektivin në paragrafin 19A.

Dhënie e informacioneve shpjeguese kur një monedhë nuk është e këmbyeshme

- A18 Njësia ekonomike do të marrë në konsideratë sesa informacion është i nevojshëm për të plotësuar objektivin e dhënies së informacioneve shpjeguese në paragrafin 57A. Njësia ekonomike do të japë informacionin e specifikuar në paragrafët A19–A20 dhe çdo informacion shtesë të nevojshëm për të plotësuar objektivin e dhënies së informacioneve shpjeguese në paragrafin 57A.
- A19 Kur zbaton paragrafin 57A, njësia ekonomike jep informacione shpjeguese për:
- (a) monedhën dhe një përshkrim të kufizimeve që sjell pakëmbyeshmëria e kësaj monedhe në monedhën tjetër;
 - (b) një përshkrim të transaksioneve që ndikohen;
 - (c) vlerën kontabël (neto) të aktiveve dhe detyrimeve që ndikohen;
 - (d) kursin e këmbimit të çastit (spot) të përdorur dhe nëse këto kurse janë:
 - (i) kurse këmbimi të vrojtueshme pa rregullime (shiko paragrafët A12–A16); ose
 - (ii) kurse këmbimi të çastit (spot) të vlerësuar duke përdorur një teknikë tjetër vlerësimi (shiko paragrafin A17);
 - (d) një përshkrim të çdo teknike vlerësimi që njësia ekonomike ka përdorur, si dhe informacion cilësor dhe sasior mbi inputet dhe supozimet e përdorura në atë teknikë vlerësimi; dhe
 - (f) informacion cilësor mbi çdo tip rreziku ndaj të cilit është ekspozuar njësia ekonomike, sepse monedha nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër, si dhe natyrën dhe vlerën kontabël (neto) të aktiveve dhe detyrimeve të ekspozuara për secilin tip rreziku.
- A20 Kur monedha funksionale e një operacioni të kryer jashtë vendit nuk është e këmbyeshme në monedhën e paraqitjes ose, nëse është e zbatueshme, monedha e paraqitjes nuk është e këmbyeshme në monedhën funksionale të një operacioni të kryer jashtë vendit, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues:
- (a) për emrin e operacionit të kryer jashtë vendit; nëse operacioni i kryer jashtë vendit është filial, operacion i përbashkët, sipërmarrje e përbashkët ose degë; dhe vendin kryesor të biznesit;
 - (b) informacion financiar të përmbledhur për operacionin e kryer jashtë vendit; dhe
 - (c) për natyrën dhe kushtet e çdo marrëveshjeje kontraktuale që mund të kërkojë që njësia të japë mbështetje financiare ndaj operacionit të kryer jashtë vendit, përfshirë ngjarjet ose rrethanat që mund të ekspozojë njësinë ekonomike ndaj një humbjeje.

Shtojca B

Ndryshime në deklaratat e tjera

Ndryshimet në këtë shtojcë do të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2005 ose më pas. Nëse njësisia ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë më të hershme, këto ndryshime do të zbatohen për atë periudhë më të hershme.

* * * * *

Ndryshimet e përfshira në këtë shtojcë kur ky Standard u publikua në vitin 2003 janë përfshirë në deklaratat përkatëse të publikuara në këtë vëllim.